



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 06 korrik 2012
Nr. ref. RK265/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI34/12

Parashtruesja

Hala Krasniqi

**Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Republikës së Kosovës A. nr. 29/2011 të 15 shkurtit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almira Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesja e Kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Hala Krasniqi nga fshati Martinaj/Plavë, Republika e Malit të Zi, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë.

Vendimi gjyqësor i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik me të cilin pretendohen shkeljet e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: "Kushtetuta") është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 29/2011 i 15 shkurtit 2011 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), të cilin parashtruesja e ka pranuar më 20 maj 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës së parashtruar më 28 mars 2012 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: "Gjykata") është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. nr. 29/2011 të 15 shkurtit 2011, sa i përket shkeljes së të drejtës së parashtruesit për pension invalidor.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 16 dhjetorit 2008, i hyrë në fuqi më 15 janar 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe Rregulli 28 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Ankesa e parashtrueses

5. Parashtruesja e kërkesës ankohet se Komisionet mjekësore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme: MPMS) ia kanë refuzuar në mënyrë joligjore të "drejtën për pension të personave me aftësi të kufizuara" edhe pse parashtruesja pretendon se i plotësonte kushtet për një pension të tillë, ndërsa, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin A. nr. 29/2011 të 15 shkurtit 2011, duke refuzuar padinë e saj lidhur me këtë çështje pretendon se ka bërë shkelje të të drejtave të saja kushtetuese, sepse, siç pohon parashtruesja, ajo nuk posedon aftësi për punë dhe këtë e ka provuar me dokumentacion mjekësor.

Procedura në Gjykatë

6. Më 28 mars 2012 Gjykata Kushtetuese pranoi kërkesën e znj. Hala Krasniqi dhe e regjistroi atë me nr. KI 34/12.
7. Më 26 2012 Kryetari, me vendimin GJR. 34/12 caktoi gjyqtar raportues, gjyqtaren Iliriana Islami. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me vendimin KSH. 34/12 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues në përbërje të gjyqtareve: 1. Almiro Rodrigues (kryesues), 2. Mr. sc. Kadri Kryeziu (anëtar) dhe 3. Prof. Dr. Enver Hasani (anëtar).
8. Më 17 maj 2012 Gjykata, njoftoi parashtruesen e kërkesës, gjithashtu dhe Gjykatën Supreme, për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 2 korrik 2012 Kryetari, me vendimin GJR. 34/12 caktoi gjyqtar raportues, gjyqtaren Snezhana Botusharova, e cila zëvendëson gjyqtaren Iliriana Islami, sepse mandati i saj si gjyqtare në Gjykatë përfundoi më 26 qershor 2012.
10. Më 3 korrik 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 20 nëntor 2004, MPMS, përkatësisht Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: DAPK), kishte lëshuar Vendimin me numër të dosjes 5014327, në bazë të së cilit parashtrueses së kërkesës, iu kishte miratuar kërkesa për pension për persona me aftësi të kufizuara.
12. Më 28 prill 2010, DAPK, duke vepruar në bazë të ankesës së parashtrueses së kërkesës, nxori Aktvendimin me nr. të dosjes 5014327, me të cilin refuzoi kërkesën e parashtrueses. DAPK ka pohuar se parashtruesja “nuk kishte dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzuese e pensionit për persona me aftësi të kufizuar dhe njëherësh kishte konstatuar se vendimi i shkallës së parë ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj”.
13. Më 31 maj 2010, parashtruesja, kishte paraqitur Padi në Gjykatën Supreme, kundër Aktvendimit me nr. të dosjes 5014327 të DAPK-së.
14. Më 8 shtator 2010, Gjykata Supreme, duke vepruar sipas padisë së parashtruar nga parashtruesja e kërkesës për iniciimin e Konfliktit Administrativ, nxori Aktgjykimin A.nr.516/2010. Më këtë rast aprovoi padinë parashtrueses dhe anuloi Aktvendimin e Këshillit të Ankesave të MPMS me nr të dosjes 5014327 të 28 prillit 2010, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të nenit 84.2 pika c dhe nenit 85.1 pika a, të Ligjit për Procedurën Administrative.
15. Më 24 nëntor 2010, MPMS, përkatësisht, Këshilli i Ankesave në kuadër të DAPK, për të dytën herë, nxori Aktvendim me numër të dosjes 5014327, me ç’rast refuzoi sërish ankesën e parashtrueses së kërkesës, duke e lënë në fuqi vendimin e komisionit mjekësor të shkallës së parë të 28 prillit 2010. Kundër këtij aktvendimi parashtruesja ka ushtruar padi për iniciimin e konfliktit administrativ në Gjykatën Suprem.
16. Më 15 shkurt 2011, Gjykata Supreme, nxori Aktgjykimin A.nr.29/2011. Me këtë aktgjykim e njëjta refuzoi padinë e ushtruar nga parashtruesja, me arsyetimin se, komisionet mjekësore të autorizuar me ligj kishin vërtetuar se te parashtruesja (paditësja) nuk ekziston aftësia e kufizuar për punë, dhe se organet administrative drejt kanë zbatuar dispozitën e nenit 3 të Ligjit për Konfliktin Administrative.

Pretendimet e parashtrueses

17. Parashtruesja e kërkesës, pretendon se, me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme A. nr. 29/2011 të 15 shkurtit 2011, i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me: Nenin 51.2 [Mbrotja Shëndetësore dhe Sociale], Kapitullin VII, [Sistemi i Drejtësisë], Nenin 102 paragrafi 3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], Nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtarë]; dhe Nenin 13 [Kartës Sociale].

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Në mënyrë që Gjykata, të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtrueses, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregulloren e punës së Gjykatës.
19. Gjykata, nga shkresat e lëndës, vëren që vendimi i kontestuar nga parashtruesja, është Aktgjykimi A. nr.29/2011, i Gjykatës Supreme miratuar më 15 shkurt 2011, i cili i është dorëzuar parashtrueses më 20 maj 2010. Ndërsa, parashtruesja kërkesën në Gjykatë e dorëzoi më 28 mars 2012, që nënkupton se kërkesa është dorëzuar jashtë afatit katër (4) muor, të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së

punës, sepse kërkesa është dashur që të dorëzohej në Gjykatën Kushtetuese, jo me vone së 20 shtatori i vitit 2011.

20. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [..]”

21. Parashtruesja, nuk ka arsyetuar në asnjë mënyrës vonesën e parashtrimit të kërkesës, andaj, barra e të provuarit bie mbi palët që parashtrojnë kërkesat e tyre në Gjykatë, nga ky këndvështrim, Gjykata, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, konsideron se kërkesa është e jashtë afatshme dhe si e tille hedhet poshtë si e papranueshme.
22. Rrjedhimisht, Kërkesa, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, Rregullin 56. (2) të Rregullores së Punës është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, më 3 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t’u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues

Snezhana Botusharova



Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani